



---

## **DEKLARATË PRELIMINARE**

**24 tetor 2017**

### **Dy fytyrat e zgjedhjeve komunale të Kosovës**

**Zgjedhjet konkurruese dhe të mirë-administruara në pjesën më të madhe të Kosovës, ndërkohë që shqetësime të thella vazhdojnë për procesin demokratik në zonat me shumicë serbe të Kosovës**

---

#### **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

---

- Zgjedhjet Komunale dhe për Kryetarë Komune të 22 tetorit janë zgjedhjet e dyta lokale që mbahen në të gjitha komunat e Kosovës që nga Marrëveshja e 19 prillit 2013 midis Prishtinës dhe Beogradit, e lehtësuar nga Bashkimi Evropian.
- Procesi zgjedhor dalloi në mënyrë të konsiderueshme në komunat me shumicë shqiptare të Kosovës në krahasim me komunat me shumicë serbe të Kosovës. Zgjedhjet në komunat me shumicë shqiptare të Kosovës ishin me të vërtetë konkurruese dhe mjedisi i fushatës ishte i qetë, duke u lejuar kandidatëve të shumtë që lirshëm t'i komunikojnë mesazhet e tyre para votuesve. Ambienti i fushatës u dëmtua nga kërcënimet brenda komuniteteve me shumicë serbe të Kosovës, në veçanti ato që i vënë në shënjestër subjektet politike jashtë Listës Serbe dhe kandidatët e tyre. Kjo përfshinte presionin mbi kandidatët individualë për t'u tërhequr dhe për ta kufizuar konkurrencën politike, gjë që ngrehu pyetje rreth parimeve kryesore të procesit të përgjithshëm demokratik në ato zona. Procesi zgjedhor në komunat me shumicë serbe në Kosovë nuk i përmbushi disa standarde ndërkombëtare dhe evropiane për zgjedhje demokratike.
- Pas zgjedhjeve parlamentare të qershorit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) e miratoi një Plan Veprimi bazuar në rekomandimet e përkohshme të EU EOM, i cili sugjeroi përmirësime që nuk kërkonin ndryshime në kuadrin ligjor për administrimin e zgjedhjeve lokale. KQZ-ja ka bërë përmirësime në edukimin e votuesve, trajnimin e anëtarëve të këshillave të vendvotimit dhe thjeshtimin e formularëve të rezultateve. Megjithatë, dobësitë e vazhdueshme të procesit zgjedhor të Kosovës nuk u adresuan në mënyrë të mjaftueshme përpara këtyre zgjedhjeve, ndër të tjera atyre që lidhen me regjistrimin e votuesve, procesin e votimit jashtë Kosovës, rritjen e transparencës rreth financimit të fushatës, zbatimin në mënyrë efektive të kërkesave për financim të fushatës dhe rregullim të programeve të sponsorizuara në TV.
- Dita e zgjedhjeve ishte e qetë, pa incidente të mëdha të regjistruara nga vëzhguesit e EU EOM të cilët i vizituan 466 vendvotime në të gjitha 38 komunat. Vendvotimet përgjithësisht u hapën me kohë dhe ishin të përgatitura për votim. Procedurat e votimit kryesisht u ndoqën dhe votimi u vlerësua pozitivisht në pothuajse të gjitha vendvotimet të vëzhguara, edhe pse ishin vërejtur raste të votimit familjar dhe abuzim i votimit me asistencë. Performanca e stafit të vendvotimit u përkeqësua në fazën e numërimit, kur 20

---

\* Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin për statusin dhe është në përputhje me RKSKB 1244/1999 dhe mendimin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

për qind e ekipeve të EU EOM e vlerësuan procesin negativisht pasi që procedurat e numërimit të votave nuk u ndoqën gjithmonë.

- Në përgjithësi, organet e administratës zgjedhore në nivel qendror dhe komunal i kryen përgatitjet teknike në mënyrë të organizuar mirë dhe transparente. Seancat e KQZ-së ishin të hapura dhe anëtarët e KQZ-së punuan kolegjisht, shpesh duke marrë vendime njëzëri. Udhëzime se a duhet të pranohen dokumentet e identifikimit të Serbisë si dokumente identifikimi për votim të rregullt mbetën të paqarta.
- Në përputhje me një marrëveshje ndërmjet KQZ-së dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), OSBE-ja ofroi këshilla dhe asistencë teknike për katër Komisionet Komunale të Zgjedhjeve dhe 86 Këshilla të Vendvotimeve në katër komunat veriore.
- Besimi publik lidhur me saktësinë e listës të votuesve është i ulët, pasi që lista përfshinë një numër të madh të personave të vdekur. Ekziston edhe rreziku sistematik që të dhënat e rreth gjysmë milioni votuesish të cilët jetojnë jashtë vendit të keqpërdoren në ditën e zgjedhjeve. Përveç kësaj, votuesit nuk janë gjithmonë të caktuar në vendvotimin më të afërt me vendbanimin e tyre. Bazuar në të dhënat e regjistrit civil, KQZ-ja i regjistroi 1,890,952 votues, një rritje prej 18,011 nga zgjedhjet e qershorit.
- Procesi i nominimit dhe certifikimit të kandidatëve për zgjedhjet lokale ishte përfshirës. Gjatë periudhës së certifikimit, u certifikuan të gjitha 91 subjektet politike të cilat aplikuan. 6,887 kandidatë të certifikuar konkurruan për kuvende komunale, nga të cilat 2,400 ishin gra. Ndërsa numri i përgjithshëm i kandidatëve për kryetarë komune ishte 204, ku vetëm tetë ishin gra.
- Për herë të parë KQZ-ja kërkoi vërtetimin lidhur me të kaluarën penale të të gjithë kandidatëve që aplikuan, siç kërkohet me ligj. 87 kandidatë të certifikuar u decertifikuan nga KQZ-ja në bazë të dënimeve të tyre penale brenda tri viteve të fundit. Tre kandidatë u ankuan pranë Gjykatës Supreme, e cila argumentoi se neni 29.1 Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) ishte jokushtetues, prandaj i hodhi poshtë që të trija vendimet dhe e urdhëroi KQZ-në që t'i certifikojë të tre kandidatët. KQZ-ja në anën tjetër vendosi në mënyrë të papritur që ta shtrijë vendimin e Gjykatës Supreme tek të gjithë 87 kandidatët të cilët fillimisht ishin decertifikuar.
- Mediat audiovizive e mbuluan gjerësisht fushatën zgjedhore në një shumëllojshmëri të formateve dhe i ofruan votuesve informata për opsionet e ndryshme politike në dispozicion. Mbulimi me lajme i fushatës zgjedhore ishte mjaft i balancuar. Mediat kryesore audiovizive organizuan pozitivisht debate përfshirëse zgjedhore midis kandidatëve për kryetarë komune të komunave me shumicën shqiptare të Kosovës, por nuk arritën sukses për komunat me shumicë serbe të Kosovës.
- Dispozitat e paqarta ligjore ua mundësuan garuesve që gjerësisht të blejnë mbulueshmëri të sponzoruar, përveç reklamimit të paguar politik që rregullohet në mënyrë të rreptë. Kjo rezultoi në atë se disa kanale televizive ofronin vëllim të konsiderueshëm të programeve të paguara krahasuar me programet editoriale, në dëm të informimit të duhur të votuesve. Komisioni i Pavarur për Media nuk i trajtoi në mënyrë efektive shkeljet e ligjit të zgjedhjeve nga ana e mediave, të cilat ndodhën gjatë fushatës zgjedhore.
- Korniza ligjore ofron bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike në pajtim me standardet ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar me Kushtetutën e saj. Ndonëse Kosova nuk është palë nënshkruese e asnjë traktati të të drejtave të njeriut, Kushtetuta

thekson se një numër i marrëveshjeve dhe i instrumenteve relevante për zgjedhjet janë drejtpërdrejt të aplikueshme në Kosovë.

- Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) vendosi me shpejtësi për numrin e madh të ankesave dhe apeleve dhe i kontribuoi procesit transparent duke i publikuar të gjitha vendimet në uebfaqen e vet. Para ditës së zgjedhjeve, PZAP pranoi 25 apele kundër vendimeve të KQZ-së, dhe 327 ankesa për shkelje të pretenduara zgjedhore. Shumica e kundërvajtjeve të vërejtura kishte të bëjë me shkeljen e Kodit të Sjelljes gjatë fushatës. 80 parashtrës u parashtruan në lidhje me votimin dhe numërimin.

---

*Me ftesën e Presidentit të Kosovës të datës 11 prill 2017, BE e dërgoi një Mision Vëzhgues të Zgjedhjeve (EOM) me 12 shtator për t'i vëzhguar zgjedhjet komunale dhe për kryetarë komune të caktuara që të mbahen me 22 tetor 2017. EU EOM udhëhiqet nga Z. Alojz Peterle, deputet i Parlamentit Evropian dhe ish Kryeministër i Republikës së Sllovenisë. Në total, EU EOM-i shpërndau në tërë Kosovën 109 vëzhgues nga 26 shtete anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra, për të vlerësuar tërë procesin zgjedhor në raport me standardet ndërkombëtare dhe evropiane për zgjedhje demokratike dhe me ligjet e Kosovës. Misionit iu bashkuan edhe 38 vëzhgues nga përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare të BE-së dhe të Norvegjisë, si dhe nga Zyra e BE-së/EUSR për të vëzhguar procesin në ditën e zgjedhjeve. Në ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit vizituan 466 vendvotime për të vëzhguar votimin dhe numërimin.*

*Kjo deklaratë preliminare publikohet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve pjesërisht do të varet nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, veçanërisht nga tabelimi i rezultateve dhe zgjidhja e parashtrësve dhe ankesave të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. EU EOM-i mbetet në Kosovë për ta vëzhguar raundin e dytë dhe zhvillimet pas zgjedhjeve dhe do ta publikojë një raport përfundimtar që përmban rekomandime të hollësishme, brenda dy muajsh pas përfundimit të procesit zgjedhor. EU EOM-i është e pavarur në gjetjet dhe konkluzionet e tij dhe bazohet në Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të nënshkruar në selinë e Kombeve të Bashkuara në tetor të vitit 2005.*

---

---

## **GJETJET PRELIMINARE**

---

### **SFONDI**

Zgjedhjet për Kryetarë Komune dhe Zgjedhjet Komunale të 22 tetorit janë zgjedhjet e dyta lokale që mbahen në të gjitha komunat e Kosovës që nga Marrëveshja e 19 prillit 2013 midis Prishtinës dhe Beogradit, dhe u organizuan pak kohë pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare 2017. Pas vonesës dy-mujore pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, Aleanca Kosova e Re (AKR) e la koalicionin parazgjedhor me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Alternativën për t'iu bashkuar Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma për Kosovën (NISMA), Listës Serbe dhe disa partive tjera politike të cilat i përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë për ta formuar ekzekutivin, edhe pse me një shumicë të ngushtë. Vetëvendosje (VV), me grupin më të madh të deputetëve, është në opozitë, siç është edhe ish-partia në pushtet, LDK.

Të gjitha partitë e përfaqësuara në Kuvend konkurrojnë në mënyrë të pavarur në këto zgjedhje komunale për dallim nga zgjedhjet parlamentare kur u formuan dy koalicione kryesore parazgjedhore. Koalicioni qeverisës dhe partitë opozitare VV dhe LDK i prezantuan kandidatët për kryetarë të komunave në shumicën e komunave. Lista Serbe i prezantoi kandidatët për kryetarë komune në të gjitha dhjetë komunat serbe ku u përball me konkurrencë të ulët, përveç në dy komuna në veri.

## **KORNIZA LIGJORE**

Korniza ligjore ofron bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike në pajtim me standardet ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar me Kushtetutën e saj. Ndonëse Kosova nuk është palë nënshkruese e asnjë traktati të të drejtave të njeriut, Kushtetuta thekson se një numër i marrëveshjeve dhe i instrumenteve relevante për zgjedhjet janë drejtpërdrejt të aplikueshme në Kosovë. Këto përfshijnë Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe protokollet e saj, si dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Në rast mospërputhje, këto instrumente kanë përparësi mbi dispozitat në ligj dhe aktet tjera të institucioneve publike. Sidoqoftë, nuk ekziston asnjë mjet juridik në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me vendimet, aktet dhe mosveprimet e ekzekutivit dhe institucioneve të Kosovës. Kodi i Praktikës së Mirë të Komisionit të Venecias në Çështjet Zgjedhore ka rëndësi si pikë referimi për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike në Kosovë.

Që nga viti 2013, tre EU EOM kanë lëshuar rekomandime se si të reformohet procesi zgjedhor për ta sjellë atë plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Këto rekomandime përfshijnë, *ndër të tjera*, përmirësimin e saktësisë së listave të votuesve, sigurimin e konsistencës ligjore për rregullat e fushatës zgjedhore, rritjen e transparencës së financimit të fushatës, zbatimin në mënyrë efektive të kërkesave financiare të fushatës, rregullimin e programeve televizive të sponsorizuara nga partitë politike dhe zgjatjen e afateve për parashtrimin dhe vendosjen e ankesave zgjedhore. Asnjë nga këto rekomandime që kërkojnë ndryshime ligjore nuk janë zbatuar.

## **SISTEMI ZGJEDHOR**

Zgjedhjet lokale në Kosovë mbahen çdo katër vjet për t'i zgjedhur kryetarët e komunave dhe anëtarët e kuvendit komunal. Kryetarët e komunave zgjedhen drejtpërsëdrejti me sistem me dy raunde. Kandidati zgjedhet kryetar i komunës nëse ai ose ajo merr më shumë se 50% të votave të përgjithshme të vlefshme të hedhura në komunë. Në komunat ku asnjë kandidat nuk e ka marrë shumicën absolute të kërkuar, mbahet raundi i dytë i zgjedhjeve katër javë pas raundit të parë, mes dy kandidatëve që e kanë marrë numrin më të madh të votave. Kandidati që fiton shumicën e votave në balotazh zgjedhet kryetar i komunës.

Anëtarët e Kuvendit Komunal zgjidhen sipas sistemit proporcional. Secila prej 38 komunave përfaqëson një zonë të vetme zgjedhore dhe numri i ulëseve varion nga 15 në 51 në proporcion me popullatën e komunës. Subjektet politike renditen në listën e hapur të votimit, ku votuesit e shënojnë një subjekt politik të preferuar dhe ia japin votën preferenciale një kandidati nga lista e subjektit politik të njëjtë. Votat preferenciale të marra nga kandidatët e secilit subjekt politik numërohen veçmas përveç për bartësit e listës i cili automatikisht i merr të gjitha votat e hedhura për subjektin politik.

Kuota gjinore kërkon që subjektet politike t'i përfshijnë së paku 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar në listë. Nga ulëset që i caktohen një subjekti politik, gjinisë e cila ka marrë më pak ulëse i caktohen të paktën 30% të numrit të përgjithshëm të ulëseve të fituara nga subjekti politik.

## **ADMINISTRATA ZGJEDHORE**

KQZ-ja është organ i përhershëm i pavarur i përbërë nga kryesuesi dhe dhjetë anëtarë të tjerë. Kryesuesi emërohet për mandat 7-vjeçar nga Presidenti i Kosovës nga mesi i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Dhjetë anëtarët e tjerë të KQZ-së emërohen nga grupet parlamentare, përfshirë edhe ata që i mbajnë ulëset e garantuara për komunitetet jo-shumicë.

Në përgjithësi, organet e administratës zgjedhore në nivel qendror dhe komunal i kryejnë përgatitjet administrative në mënyrë të mirë-organizuar dhe transparente. Seancat e KQZ-së ishin të hapura dhe anëtarët e KQZ-së punuan kolegjisht, shpesh duke marrë vendime njëzëri. Megjithatë kishte udhëzime të paqarta se a duhet të pranohen dokumentet e identifikimit të Serbisë si dokumente identifikimi për votim të rregullt.

KQZ-ja e ruajti një qasje përfshirëse dhe të balancuar në emërimin e 38 Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe 2,505 anëtarë të Këshillave të Vendvotimeve (KVV), përfshirë të nominuarit nga subjektet e ndryshme që i përfaqësojnë serbët e Kosovës dhe komunitetet tjera jo-shumicë. Gratë përfaqësojnë vetëm 11% të anëtarëve dhe kryesuesve të KKZ-së. Përqindja e grave ndërmjet anëtarëve të emëruar të KVV-ve është rreth 26%, e cila, me përjashtim të Mitrovicës (Veriut) dhe Prishtinës, është ende shumë nën objektivin prej 40% të deklaruar nga partitë kryesore politike.

#### *Plani i Veprimit i KQZ-së bazuar në rekomandimet e përkohshme të EU EOM*

Pas zgjedhjeve parlamentare të qershorit, KQZ e miratoi një Plan Veprimi bazuar në rekomandimet e përkohshme të EU EOM, i cili sugjeroi përmirësime që nuk kërkojnë ndryshime në kuadrin ligjor për administrimin e zgjedhjeve lokale 2017. KQZ-ja e ka përmirësuar Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit, i ka thjeshtuar formularët e rezultateve, i ka përmirësuar trajnimet e KVV-ve dhe Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, i ka prezantuar masat për ta rritur transparencën dhe saktësinë e operacioneve të saj.

KQZ-ja e zhvilloi një fushatë intensive 10-ditore të informimit të votuesve me spotet e ndryshme të transmetuara nga mediat kryesore transmetuese që shpjegonin se si plotësohen dy fletëvotimet me qëllim të zvogëlimit të numrit të konsiderueshëm të fletëvotimeve të pavlefshme të vërejtura në zgjedhjet e kaluara. Për shkak të procesit të prokurimit të kontestuar, KQZ-ja nuk mundi që ta implementojë plotësisht fushatën e saj të informimit të votuesve. Kjo ndikoi në mënyrën se si votuesit janë informuar lidhur me kërkesën për ndryshimin e qendrës së votimit ose regjistrimin si votues jashtë Kosovës.

Janë zbatuar disa masa themelore anti-mashtrim të rekomanduara nga EU EOM: referencat në dispozitat e Kodit Penal për veprat penale zgjedhore dhe një seksion për parashtrës në PZAP u përfshinë në Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit. Prokurorët u caktuan në të gjitha 38 komunat që nga fillimi i fushatës zgjedhore deri në fund të procesit zgjedhor.

#### **PROCESI ZGJEDHOR NË KATËR KOMUNAT VERIORE**

Në përputhje me një marrëveshje ndërmjet KQZ-së dhe OSBE-së, kjo e fundit ofroi këshilla dhe asistencë teknike për katër KKZ-të dhe 86 KVV-të në katër komunat veriore. Në ditën e zgjedhjeve, ekipet e OSBE-së ishin të pranishme në KKZ dhe në secilin vendvotim që nga hapja e deri në përfundim të numërimit, me autoritetin për t'i raportuar shkeljet dhe për t'i vënë në pah parregullsitë tek zyrtarët zgjedhorë. Personeli i OSBE-së e shoqëroi transportin e materialeve zgjedhore nga vendvotimet gjer në qendrat e grumbullimit të KKZ-ve në veri dhe më pas në Qendrën për Numërim dhe Rezultate.

#### **REGJISTRIMI I VOTUESVE**

Besimi publik lidhur me saktësinë e listës të votuesve është i ulët, pasi që lista përfshinë një numër të madh të personave të vdekur. Personat e vdekur nuk janë hequr nga lista e votuesve me kohë për shkak të mangësive në procedurat për regjistrimin e vdekjeve. Certifikatat e vdekjes, që kërkojnë për heqjen e një votuesi nga lista, lëshohen vetëm me kërkesë të familjes. Shumë familje nuk i raportojnë vdekjet, pasi që vazhdojnë të marrin përfitime sociale për të ndjerin. Masat e

fundit të marra nga ARC-ja për ta adresuar çështjen kanë efekt të kufizuar dhe nuk zbatohen në mënyrë të njejtë nga të gjitha Zyrat Komunale të Gjendjes Civile.

Ekziston edhe rreziku sistematik që të dhënat e rreth gjysmë milioni votuesish të cilët jetojnë jashtë vendit të keqpërdoren në ditën e zgjedhjeve. Përveç kësaj, votuesit nuk janë caktuar gjithmonë në vendvotimin më të afërt me vendbanimin e tyre, siç thuhet për shkak të mangësive në sistemin e adresave në Kosovë dhe për faktin se votuesit zakonisht nuk e ndërrojnë letërnjoftimin kur lëvizin në një vend tjetër.

Bazuar në të dhënat nga Regjistri Civil, KQZ-ja i regjistroi 1,890,952 votues, që është rritje prej 18,011 nga zgjedhjet e qershorit. Agjencia e Statistikave të Kosovës vlerëson se afërsisht 700,000 kosovarë banojnë jashtë vendit dhe përveç atyre që me sukses kanë aplikuar për votim jashtë Kosovës, shumica e atyre që janë në moshë të votimit ende janë të pranishëm në listën e votuesve.

Interpretimet e rregullave në lidhje me provat për shtetësi të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe vendbanimit të përhershëm në territorin e Kosovës në janar 1998 ia vështirësojnë disa personave nga komunitetet jo-shumicë që ta marrin letërnjoftimin e Kosovës dhe kështu të përfshihen në listën e votuesve. Kjo sidomos ka të bëjë me të rinjtë dhe të lindurit jashtë Kosovës ku vetëm njëri prind e zotëron letërnjoftimin e Kosovës, serbët e kthyer të Kosovës, dhe gjithashtu pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Situata është e koklavitur në katër komunat veriore, ku Zyrat e Gjendjes Civile nuk janë plotësisht funksionale.

### **VOTIMI JASHTË KOSOVËS**

Operacioni i votimit jashtë Kosovës ishte përfshirës, megjithatë, mungonin masat mbrojtëse kundër abuzimeve të mundshme. Në fillim të periudhës pesë-javore të aplikimit, KQZ-ja i dërgoi formularët e aplikimit direkt 15,118 votuesve të cilët u regjistruan si votues jashtë Kosovës për zgjedhjet parlamentare të qershorit. KQZ pranoi 11,813 aplikacione për votim jashtë Kosovës dhe i miratoi 10,476 prej tyre. Numri më i madh i aplikacioneve për votim jashtë Kosovës ishin nga Serbia (3,244), Zvicra (2,226) dhe Gjermania (1,400). Procesi i votimit me poshtë nga jashtë Kosova filloi më 22 shtator dhe përfundoi më 20 tetor 2017.

Nuk ka masa të mjaftueshme mbrojtëse kundër keqtrajtimit në procesin e votimit jashtë Kosovës dhe ka mungesë të mjeteve juridike efektive për rastet e mospranimit të së drejtës për votim. Së paku 34 votues u hoqën nga lista e votuesve pasi që dikush kishte aplikuar për votim jashtë Kosovës në emër të tyre. Meqenëse personat e privuar nga e drejta për votë e kuptuan këtë vetëm pasi afati i ankesës kishte kaluar, dhe nuk kishin vend ligjor për korrigjim.

### **REGJISTRIMI I KANDIDATIT**

Procesi i nominimit dhe certifikimit të kandidatëve për zgjedhjet lokale ishte përfshirës. Gjatë periudhës së certifikimit, u certifikuan të gjitha 91 subjektet politike të cilat aplikuan. Midis tyre ishin 35 parti të regjistruara politike, një koalicion, 30 iniciativa qytetare dhe 25 kandidatë të pavarur. 6,887 kandidatë të certifikuar konkurruan për kuvendet komunale, nga të cilat 2,400 ishin gra. Ndërsa numri i përgjithshëm i kandidatëve për kryetarë komune ishte 204, ku vetëm tetë ishin gra.

Për herë të parë që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) në vitin 2008, KQZ-ja i kërkoi vërtetimin lidhur me të kaluarën penale të të gjithë kandidatëve, siç kërkohet me ligj. Meqenëse Kosova nuk operon me një bazë të të dhënave të integruara gjyqësore, KQZ-së iu deshtë që t'i kontaktojë të gjitha gjykatat themelore në Kosovë për informim. 87 kandidatë të certifikuar u decertifikuan nga KQZ-ja në bazë të dënimeve të tyre penale brenda tri viteve të fundit. 17 prej këtyre kandidatëve të decertifikuar i dorëzuan ankesat pranë PZAP, të cilat u refuzuan si të pabaza. Tre nga këta ankues, duke e përfshirë një Deputet, u ankuan kundër

vendimeve të PZAP-së në Gjykatën Supreme, e cila i hodhi ato poshtë dhe e urdhëroi KQZ-në që të ri-certifikojë tre kandidatët.

Gjykata Supreme argumentoi se neni 29.1 i LZP ishte jokushtetues. Kjo pyetje ende nuk i është dërguar Gjykatës Kushtetuese. KQZ-ja vendosi papritmas që ta shtrijë vendimin e Gjykatës Supreme tek të gjithë 87 kandidatët që fillimisht ishin decertifikuar për shkak të dënimeve penale. Vetëm 27 nga 87 kandidatët e ri-certifikuar dhanë dorëheqje ose u zëvendësuan nga subjektet e tyre politike.

## **MJEDISI I FUSHATËS**

Në përgjithësi, atmosfera ishte e qetë dhe fushata nuk ishte intensive në zonat me shumicë shqiptare të Kosovës, ku aktivitetet u intensifikuan gjatë javës së fundit para ditës së zgjedhjeve. Në përgjithësi, garuesit ishin në gjendje që të bënin fushatë lirshëm. Megjithatë, vëzhguesit e EU EOM pranuan raportime se në një numër të kufizuar të rasteve, punonjësit publikë, siç janë mësimdhënësit dhe punonjësit e qendrës shëndetësore, ishin vënë nën presion për t'i mbështetur kandidatët e caktuar ose u penguan nga pjesëmarrja në aktivitetet e fushatës. Shumë subjekte politike u dhanë përparësi fushatës derë-më-derë, takimeve të vogla të përshtatura për një grup të caktuar të votuesve dhe përdorimit të mediave sociale, duke organizuar tubime më të mëdha vetëm në fund të fushatës. Shumë liderë të subjekteve politike në mënyrë të dukshme morën pjesë në fushatë, duke i dhënë përkrahje kandidatëve të tyre vendorë.

Mjedisi i fushatës u dëmtua nga një sjellje e thellë e frikësimit brenda komunitetit serb të Kosovës, duke i vënë në shënjestër subjektet politike dhe votuesit që nuk ishin të Listës Serbe. Kjo përfshinte presionin mbi kandidatët individualë për t'u tërhequr dhe për ta kufizuar konkurrencën politike, gjë që ngriti pyetje rreth procesit të përgjithshëm demokratik në ato zona. Disa kandidatë të subjekteve politike jashtë Listës Serbe u tërhoqën nga gara siç thuhet si rezultat i këtij kërcënimi. Partitë kryesore opozitare, duke përfshirë e Partinë e Pavarur Liberale (SLS) dhe Partinë e Serbëve të Kosovës (PKS), nuk i nominuan kandidatë për kryetarë komune në shumicën e komunave me shumicë serbe<sup>1</sup>.

EU EOM mori raportime lidhur me institucionet që funksionojnë në të ashtuquajturin sistem paralel serb në Klllokot dhe Ranillug që ishin përfshirë në ushtrimin e presionit dhe në shkarkime nga puna të kandidatëve që nuk ishin të Listës Serbe dhe të familjarëve të tyre. Rastet më të rënda të kërcënimeve që përfshinin kandidatët jashtë Listës Serbe rrallëherë u raportuan në sistemin gjyqësor të Kosovës. Mjedisi i fushatës ishte veçanërisht i tensionuar në veri, me incidente të përsëritura të dhunshme që përfshinin anëtarët e PKS dhe Listës Serbe në Leposaviq.

Vëzhguesit e EU EOM morën raportime për keqpërdorimin e burimeve publike në një numër të kufizuar të rasteve në Viti, Klllokot dhe Zveçan. Për më tepër, kryeministri bëri fushatë së bashku me kandidatët e AAK-së për kryetarë komune, duke premtuar fonde për projektet lokale nëse zgjidhen ata.

Partitë politike nuk e përfshinë pjesëmarrjen e grave në mesin e prioritetëve të tyre gjatë fushatës. Gratë përgjithësisht u nënpërfaqësuan në audiencë në ngjarjet e fushatës dhe morën më pak mbështetje nga partitë e tyre për të kandiduar për zgjedhje. Manifestimet zgjedhore të shumicës së subjekteve politike ofruan detaje të kufizuara për politikën specifike që e inkurajojnë angazhimin më të madh të grave në jetën publike.

---

<sup>1</sup> Kishte incidente të dhunshme, përfshirë djegien e veturave të Oliver Ivanoviqit dhe Dragisha Miloviqit në Mitrovicë (Veri) para fillimit të fushatës zyrtare.

## **FINANCIMI I FUSHATËS**

LZP, Ligji për Financimin e Partive Politike dhe disa rregullore të KQZ-së për financimin e fushatës sigurojnë kuadrin ligjor për burimet e të ardhurave dhe shpenzimet e subjekteve politike. Kjo kornizë synon që ta nivetojë fushën e lojës duke vendosur kufijtë e shpenzimeve dhe kërkesat për shpalesje, procedurat e auditimit dhe gjobat. Megjithatë, raportet financiare të subjekteve politike nuk kanë qenë subjekt i auditimit që nga viti 2013 dhe nuk janë vënë në dispozicion për shqyrtim publik, duke mos i përmbushur kërkesat ligjore për transparencë dhe llogaridhënie të financimit të fushatës.

Kufiri i shpenzimeve për secilin subjekt të certifikuar gjatë fushatës zgjedhore përcaktohen me 0.5 Euro për votues të regjistruar dhe kështu varion varësisht nga madhësia e komunës. Kandidatët individualë që mbledhën fondet e tyre për fushatën duket se besojnë se këto nuk duhet të përfshihen në raportet financiare, gjë që është në kundërshtim me kërkesat ekzistuese ligjore. Mungesa e një monitorimi sistematik të financimit të fushatës dhe fushëveprimi i kufizuar i mekanizmit të rishikimit financiar ngrehtë pyetje për tejkalimin e kufirit të përcaktuar me ligj.

## **MEDIA**

Mjedisi medial është i gjallë dhe pluralist dhe u ofroi informata votuesve për opsionet e ndryshme politike në dispozicion. Legjislacioni për mediat ofron një kornizë të shëndoshë për lirinë e mediave dhe gazetaret në përgjithësi ishin në gjendje që ta ushtrorjnë profesionin e tyre lirshëm. LZP-ja kërkon që të gjitha mediat ta sigurojnë mbulim të drejtë dhe të paanshëm të garuesve, i lejon reklammat me pagese dhe parasheh qasje në transmetim pa pagesë për të gjitha subjektet politike.

Televizioni dhe mediat e lajmeve online ishin burimi primar i informimit për votuesit. Mediat sociale u përdorën kryesisht nga mediat tradicionale dhe online për ta shpërndarë përmbajtjen e tyre duke përfshirë transmetimin e drejtpërdrejtë të debateve zgjedhore dhe ngjarjeve të fushatës. Mediat kryesore transmetuese abstenuan nga mesazhet nxitëse dhe e mbuluan gjerësisht fushatën zgjedhore në forma të ndryshme, ndërkohë që shumica e mediave lokale transmetuese ofruan mbulim të kufizuar të zgjedhjeve. Mediat e lajmeve online e mbuluan gjerësisht fushatën zgjedhore lokale; megjithatë, shumica e mbulimit u bazua në informatat e mbledhura nga agjencitë e lajmeve dhe burimet tjera mediale.

Mbulimi i lajmeve nga mediat transmetuese të fushatës zgjedhore u përqendrua në partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, ku partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur pothuajse mungonin nga mbulimi i fushatës<sup>2</sup>. Kanali televiziv publik RTK1 ofroi një mbulim mjaft të balancuar, duke ia dedikuar 17 për qind LDK-së, nga 16 për qind PDK-së e Vetëvendosjes dhe 14 për qind AAK-së nga mbulimi i lajmeve të subjekteve politike dhe institucionale. Edhe kanalet televizive private të monitoruara ofruan një mbulim mjaft të balancuar të LDK-së, PDK-së, Vetëvendosjes dhe AAK-së me mbulim më të kufizuar të AKR-së dhe NISMA-së. Dy kanale televizive private, *KTV* dhe *TV Dukagjini*, ofruan një mbulim të rëndësishëm Kryeministrit dhe udhëheqësve të AAK-së, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij institucional.

Të gjitha kanalet televizive kryesore të monitoruara zhvilluan debate gjithëpërfshirëse zgjedhore midis kandidatëve për kryetarë komune në shumicën e komunave duke u lejuar kandidatëve që të prezantohen, si dhe duke u mundësuar votuesve që të bëjnë zgjedhje të informuar. Megjithatë, kandidatët shpenzuan një pjesë të konsiderueshme të debateve zgjedhore në akuza politike në

---

<sup>2</sup>EU EOM monitoroi çdo ditë nga 17:00 deri në 01:00 dy kanalet televizive publike (RTK1, RTK2) dhe katër kanalet televizive private (RTV 21, KTV, Klan Kosova dhe TV Dukagjini), si dhe edicionin e lajmeve në kohën e shikueshmërisë së lartë të TV Most dhe TV Puls dhe një mostër të mediave online të lajmeve.



vend se t'i prezantojnë dhe t'i diskutojnë platformat e tyre. Përkundër numrit shumë të kufizuar të grave që konkurrojnë për postet e kryetarit të komunës, mediat audivizive bënë përpjekje pozitive për t'i ftuar në programet e tyre gratë kandidatë për kryetarë komune dhe kuvende komunale. Megjithatë, vetëm kanali RTV21 prezantoi në të gjitha debatet e tij zgjedhore diskutimet për barazinë gjinore.

Përveç spoteve të paguara politike të rregulluara me rigorozitet, partitë kryesore politike gjerësisht bënë fushatë në TV duke përfutur nga një mangësi në ligj e cila u lejon kanaleve televizive që të transmetojnë programe pa kufizime. Për më tepër, në disa raste programet e sponsorizuara përfshiheshin në lajme ose nuk ishin etiketuar qartë si programe të paguara, duke e paqartësuar vijën mes materialit editorialit dhe të paguar, në dëm të publikut. Monitorimi i mediave nga EU EOM vërejti disa shkelje të ligjit që kishin të bënin me spotet politike të paguara dhe me respektimin e periudhës së heshtjes. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), përgjegjës për mbikëqyrjen e medias audivizive, nuk i ka adresuar ose sanksionuar në mënyrë efektive shumicën e shkeljeve të detektuara gjatë fushatës zgjedhore.

Duke reflektuar fushatën me intensitet të ulët në komunat me shumicë serbe të Kosovës, nuk pati pothuajse asnjë mbulim lajmesh të këtyre garave për kryetarë komune në mediat audivizive të monitoruara dhe asnjëra prej tyre nuk arriti që të organizonte debate zgjedhore midis kandidatëve për kryetarë komune. Disa transmetues lokal dhe online medial në katër komunat me shumicë serbe të Kosovës u ballafaquan me përçarje të jashtme, që ndikoi në aftësinë e tyre për ta mbuluar lirshëm fushatën zgjedhore.

#### **SHOQËRIA CIVILE DHE VËZHGUESIT VENDORË**

KQZ-ja ka akredituar gjithsej 33,862 vëzhgues në mënyrë përfshirëse, duke e rritur transparencën e procesit zgjedhor. Më shumë se 29,000 vëzhgues të akredituar ishin nga subjektet politike të certifikuara dhe rreth 3,700 nga OJQ-të vendore.

Grupi kryesor vendor i vëzhgimit të Kosovës, Demokracia në Veprim (DNV), i trajnoi dhe i zbarkoi rreth 3.000 vëzhgues të zgjedhjeve. Qendra e Thirrjeve e DNV-së i mblodhi rezultatet e zgjedhjeve të kryetarëve të komunave nga vëzhguesit në vendvotime në komunat më të mëdha dhe e publikoi një tabelë paralele të votimit në natën e zgjedhjeve.

#### **ZGJIDHJA E KONTESTEVE NË ZGJEDHJE**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) është institucion i pavarur i përbërë nga gjyqtarë përgjegjës për t'i gjykuar parashtrësit lidhur me zgjedhjet dhe ankesat kundër vendimeve të KQZ-së. PZAP veprroi shpejt me numrin e madh të parashtrësive dhe i publikoi të gjitha vendimet e në uebfaqen e saj, duke kontribuar në një proces transparent. Deri në ditën e zgjedhjeve, PZAP pranoi gjithsej 352 ankesa dhe parashtrësia lidhur me zgjedhjet lokale aktuale. Përveç 17 ankesave kundër vendimeve të KQZ-së për decertifikimin e kandidatëve, PZAP i shqyrtoi rastet lidhur me aktivitetet e periudhës para dhe pas fushatës, tërheqjen e kandidatëve nga listat e subjekteve politike, emërimin e anëtarëve të KKZ-ve dhe kryesisht për aktivitetet e fushatës. Për shkak të burimeve, kohës dhe kufizimeve të stafit, PZAP zakonisht nuk zhvillon seanca dëgjimore, por ata i mbajtën katër seanca dëgjimore gjatë këtyre zgjedhjeve deri tani, si dhe një seancë publike të Panelit në lidhje me 23 raste. Deri më 22 tetor, PZAP shqiptoi gjopa për kandidatët dhe subjektet politike në shumë prej 196,750 euro, kryesisht për shkeljet e vogla të Kodit të Sjelljes gjatë fushatës, siç janë posterat e fushatës në vende të papërshtatshme dhe paraqitja e fëmijëve në aktivitetet e fushatës. Deri më 23 tetor në mbrëmje, janë parashtruar 80 parashtrësia në lidhje me votimin dhe numërimin, kryesisht në lidhje me rezultatet e kandidatëve.

### **DITA E ZGJEDHJEVE**

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë, pa incidente të mëdha të regjistruara nga vëzhguesit e EU EOM të cilët i vizituan 466 vendvotime në të gjitha 38 komunat. Vendvotimet përgjithësisht u hapën me kohë dhe ishin të përgatitura për votim. Kryesisht u respektua procedura e hapjes dhe hapja u vlerësua pozitivisht në të gjitha vendvotimet e vëzhguara.

Në përgjithësi, procesi i votimit u vlerësua si i mirë ose shumë i mirë në 99% të vendvotimeve. Përgjithësisht u ndoqën procedurat e votimit. Vëzhguesit e EU EOM vunë në dukje shumë raste të votimit familjar (në 10% të vëzhgimeve). Disa votues u kthyen mbrapsht në 11% të vendvotimeve të vëzhguara, kryesisht sepse nuk ishin në listën e votuesve, pasi që kryesisht paraqiteshin në vendvotimin e gabuar. Sipas të dhënave të regjistruara në Librat e Votimit, në 21% të vendvotimeve të vëzhguara përqindja e votimit të ndihmuar ishte mbi 10%.

Çështja e dokumenteve të pranuar nuk u sqarua mjaftueshëm nga KQZ-ja. Në shumicën e vendvotimeve të vëzhguara, u pranuan letërnjoftimet serbe për votim të rregullt, me një numër të vogël përjashtimesh. Për votimin me kusht, nuk kishte interpretim uniform të rregullave nga stafi i KVV-së nëpër vendvotime të ndryshme.

Performanca e stafit të vendvotimeve u përkeqësua në fazën e numërimit, me vetëm 80% të numrit të votave të vlerësuara si pozitive. Megjithëse KQZ i ka thjeshtuar formularët e rezultateve, stafi i vendvotimit në një të tretën e vendvotimeve të vëzhguara kishte vështirësi në plotësimin e formularëve të rezultateve të kandidatëve. Vështirësitë në plotësimin e Formularëve të Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve u vunë re në 37% të numërimit të votave të vëzhguara.

KKZ-të u vizituan nga vëzhguesit e EU EOM në 30 komuna. Prosesi u vlerësua si pozitiv në të gjitha KKZ-të. Korrigjimet në materialet dhe dokumentet e vendvotimeve kërkoheshin të paktën një herë në 40% të KKZ-ve të vëzhguara, që tregon për nevojat për trajnim shtesë për stafin e KVV-ve.

Dy kanale kryesore private televizive, Klan Kosova dhe TV Dukagjini, e shkelën periudhën e heshtjes së fushatës duke mbuluar konferencat për shtyp të partive politike gjatë ditës së zgjedhjeve.

---